



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuuesi **Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe krimit të Organizuar** me datë **24.12.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit personal “*Arrest në burg*” e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, e caktuar ndaj kërkuetit (personit nën hetim) me vendimin Nr. 54, dt. 06.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe me vendimin nr. 997 Akti, dt. 18.04.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shkak të kalimit të kohëzgjatjes maksimale të masës së sigurimit sipas përcaktimeve të nenit 263/1 shkronja b) të K.Pr.Penale. Caktimin ndaj personit nën hetim Arben Rushiti të masës së sigurimit personal “*Arrest në shtëpi*” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale”.

2. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Çela, bazuar në nenet 112, 237, 263/1 shkronja “b” dhe 266 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. 755, datë **26.12.2024**, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuetit Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe krimit të Organizuar.
2. Konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit personal “*Arrest në burg*” e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale e caktuar ndaj personit nën hetim **Arben Rushiti** me vendimin Nr. 54, dt. 06.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe me vendimin nr. 997 Akti, dt. 18.04.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shkak të kalimit të kohëzgjatjes maksimale të afateve të masës së sigurimit sipas përcaktimeve të nenit 263/1 shkronja b) të K.Pr.Penale.
3. Caktimin ndaj shtetasit **Arben Rushiti**, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Falsifikimi i dokumentave*” kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal; “*Grupi i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale apo grupi kriminal*” të parashikuara nga nenet 186/1 - 28/4; 333/a dhe 334/1 të Kodit Penal të masës së sigurimit personal “*Arrest në shtëpi*” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale.
4. Urdhërohet personi nën hetim **Arben Rushiti** që të mos largohet nga banesa e tij që ndodhet në *****.

5. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i personit nën hetim **Arben Rushiti** nga ambjentet e paraburgimit nëse ai nuk mbahet i arrestuar me ndonjë masë tjetër sigurimi “*Arrest në burg*” si i dyshuar për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale apo me ndonjë vendim dënimi me burgim.
6. Urdhërohet policia gjyqësore dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për zbatimin e këtij vendimi.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brënda 5 ditëve, afat ky që fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

Tiranë, më datë 26.12.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar